



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 37/2023 regjistër (JR)
Datë 02.08.2023

Nr. 73 i vendimit
Datë 17.10.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– shpalli në seancë gjyqësore publike, ditën e premte, datë 17.10.2025, në orën 12:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Griselda Muça, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 37/2023 (JR), datë 02.08.2023, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik, Florjan Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 650, datë 27.04.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi përfaqësuesin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, z. Klodjan Braho¹, prokuror pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, i cili përfundimisht kërkoi lënie në fuqi të vendimit të

¹ Sipas autorizimit nr. {***} prot., datë 22.09.2025.

Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 650, datë 27.04.2023, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj, dhe avokaten e tij, znj. R. Z., që përfundimisht kërkuan lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka kryer procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit mbështetur në të 3 (tri) kriteret e vlerësimit përkatësisht: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Në respektim të parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, përkatësisht të neneve 33, 39 dhe 44, Komisioni ka administruar raportet e hartuara nga strukturat ndihmëse, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim “AKSIK”) si dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).

2.1. ILDKPKI-ja, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, ka konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë burimesh të ligjshme financiare për krijimin e pasurive; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2. AKSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit nëpërmjet verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të përcaktohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Në përfundim të procesit verifikues, AKSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin e hartuar për subjektin e rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj, me konstatimin për përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës.

2.3. KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe duke përzgjedhur 5 (pesë) dokumente të tjera ligjore, sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për të.

II. Vendimi i Komisionit

3. Vendimi i Komisionit për subjektin e rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj është marrë bazuar në të tri kriteret: vlerësimin të pasurisë, kontrollin të figurës dhe vlerësimin të aftësive profesionale, për të cilat është konkluduar se:

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj *ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë*, sipas nenit 59/a të ligjit.
 - Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj *ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës*, sipas nenit 59/b të ligjit.
 - Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj *ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale*, sipas nenit 59/c të ligjit.
4. Në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar, Komisioni, bazuar në nenin 58, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 650, datë 27.04.2023, ka vendosur: *“Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë”*.

III. Ankimi i Komisionerit Publik dhe procedura e shqyrtimit

5. Komisioneri Publik Florian Ballhysa ka ushtruar ankim ndaj vendimit nr. 650, datë 27.04.2023, të Komisionit, pasi ka konstatuar se nga shqyrtimi i këtij vendimi dhe akteve shoqëruese të tij, paraqiten rrethana të tilla ligjore e fakti, të cilat çmon se e bëjnë të cenueshëm vendimin në tërësinë e tij, duke parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, si vijon.
- 5.1. Në analizë të gjetjeve të Komisionit mbi çështjet e analizuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, lidhur me të ardhurat nga ferma, që deklarohen si një nga burimet e krijimit të pasurive në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, para fillimit të detyrës, Komisioneri Publik vlerëson se, në gjendjen që janë aktet, duket se nuk provohet realizimi faktik i këtyre të ardhurave dhe as masa e tyre. Të ardhurat e pretenduara me burim nga ferma mbeten në nivel deklarativ, duke mbetur kështu i paprovuar burimi i krijimit për kursimet *cash*, në vlerën 20.000.000 lekë dhe pasuritë e rrjedhura prej këtyre kursimeve. Gjithashtu, Komisioneri Publik konstaton se subjekti i rivlerësimit: (i) ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me pjesën takuese të likuiditeteve *cash*, pasi në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës deklaroi pjesë takuese 50%, ndërsa gjatë hetimit administrativ deklaroi pjesë takuese 25%; (ii) ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me likuiditetet *cash*, pasi nuk ka deklaruar ndryshime në deklaratat periodike vjetore, si dhe nuk ka deklaruar kursime *cash* në deklaratën *vetting*; (iii) nuk rezultoi të ketë deklaruar në asnjë prej deklaratave të pasurisë huan dhënë shtetasit N. J. në mars të vitit 2013, dhe as kthimin e saj në datën 28.04.2016; (iv) ka kryer deklaram kontradiktor lidhur me destinacionin dhe shlyerjen e kredisë së marrë në korrik të vitit 2014. Në përfundim të sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e deklaramit të pasaktë dhe, si rezultat, është e pamundur të arrihet në një konkluzion se cilat janë deklaramet e subjektit të rivlerësimit që përputhen me situatën e vërtetë faktike lidhur me dinamikën dhe gjendjen e kursimeve *cash*. Në këto rrethana, Komisioneri Publik vlerëson se, referuar deklarameve të subjektit të rivlerësimit të administruara për efekt të procesit të rivlerësimit dhe gjendjes së dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të tij dhe të personit të lidhur me të, subjekti i

rivlerësimit dhe personi i lidhur me të ndodhen në kushtet e pamjaftueshmërisë, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

5.2. Për sa i përket kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale dhe etikës së subjektit të rivlerësimit, Komisioneri Publik vlerëson se të metat e konstatuara në shqyrtimin e disa çështjeve penale, si dhe nga denoncimet e publikut, të trajtuara gjatë procesit të rivlerësimit, duhet të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave të çështjes së subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

6. Komisioneri Publik, për shkak se përfundimet e arritura nga Komisioni duket se nuk janë në pajtueshmëri me provat e administruara, dhe vendimi i Komisionit përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’iu nënshtruar juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit, bazuar në nenet Ç, D, E dhe F të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 4, pika 2 dhe nenin 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016, ka kërkuar që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe në përfundim të gjyqimit të vendosë ndryshimin e vendimit nr. 650, datë 27.04.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegj

a) Juridiksioni i Kolegjit

7. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”) ka juridiksion *ratione materiae* të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, i parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit mbi bazën e ankimit të Komisionerit Publik dhe duke mos qenë në kushtet e parashikuara nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

b) Legjitimimi i ankuesit

8. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të çështjes

9. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit ndaj vendimit nr. 650, datë 27.04.2023, të Komisionit, duke qenë se është ushtruar nga Komisioneri Publik, u zhvillua në seancë gjyqësore publike.

10. Trupi gjykues, për shkak të mbarimit të mandatit kushtetues të institucionit të Komisionerëve Publikë, në zbatim të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës² dhe nenit 199, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile, në seancën gjyqësore publike të datës 29.09.2025, vendosi kalimin procedural nga Komisioneri Publik te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

B. Shqyrtimi gjyqësor i çështjes në Kolegj

11. Në seancën gjyqësore publike të datës 29.09.2025, në parashtrimet e tij përpara Kolegjit lidhur me ankimin, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, z. Klodjan Braho, deklaroi se u qëndron të gjitha shkaqeve të ankimit të ushtruar nga Komisioneri Publik kundër vendimit nr. 650, datë 27.04.2023, të Komisionit, pasi ankimi në rastin konkret evidenton dhe parashtron si çështje për gjykim rrethana dhe fakte ligjore, për të cilat ndan qëndrim të ndryshëm nga vlerësimi i Komisionit. Për rrjedhojë të sa më sipër, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme i qëndroi kërkimit të ankimit për ndryshimin e vendimit nr. 650, datë 27.04.2023, të Komisionit dhe për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.
12. Po në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit dhe avokatja e tij, në përfundim të parashtrimeve lidhur me ankimin, kërkuan mospranimin e tij dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionit, si një vendim i mbështetur në një shqyrtim të drejtë dhe në përputhje me standardet kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë procesin e rivlerësimit kalimtar. Së bashku me parashtrimet, subjekti i rivlerësimit paraqiti disa akte shkresore, për të cilat kërkoi marrjen e tyre nga Kolegji në cilësinë e provave të reja në proces nëpërmjet çeljes së hetimit gjyqësor, me qëllim shqyrtimin e plotë të rrethanave faktike që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe të atij profesional.
13. Trupi gjykues, pasi dëgjoi edhe përfaqësuesin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, lidhur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit, me vendim të ndërmjetëm, bazuar në nenin F, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenet 45 dhe 49, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, vendosi çeljen e hetimit gjyqësor dhe marrjen në cilësinë e provës të akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, me përjashtim të një akti që nuk përmbushte kriteret e kërkuara nga ligji për sa i përket formës, të cilin subjekti i rivlerësimit e paraqiti të plotësuar në seancën pasardhëse në Kolegj.
14. Në seancën e datës 15.10 2025, në fazën procedurale të bisedimeve përfundimtare, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, është shprehur se në një vlerësim të përgjithshëm të situatës faktike dhe ligjore të subjektit të rivlerësimit, si dhe duke i parë këto rrethana në raport me objektivat e procesit të rivlerësimit kalimtar, vëren se: (i) rezultoi e provuar mbi bazën e një sërë aktesh të administruara në dosje se familja e subjektit të rivlerësimit ka ushtruar në mënyrë të vazhdueshme aktivitet bujqësor dhe blegtoral, që prej fillimit të viteve 90'; (ii) kursimet *cash*, të cilat janë bërë objekt shqyrtimi në këtë proces, janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën para fillimit të detyrës dhe i përkasin një kohe kur ai nuk ushtronte funksione publike; (iii) pasaktësitë apo mangësitë e evidentuara në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me kursimet *cash*, duket se lidhen me karakterin e përbashkët familjar të këtyre kursimeve, si dhe me distancën gjeografike dhe kohore që subjekti ka pasur nga aktiviteti bujqësor familjar gjatë viteve të studimeve dhe punësimit në kryeqytet; (iv) pasuritë në pronësi të vëllait të subjektit të rivlerësimit dhe shpenzimet e kryera prej tij, siç

² Referuar parashikimit të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës me mbarimin e mandatit kushtetues së institucionit të Komisionerëve Publikë, kompetencat e tyre ushtrohen nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

rezulton nga deklaratimet e vetë subjektit dhe nga provat e tjera të administruara në dosje, nuk rezultojnë të jenë fryt i ndonjë aktiviteti individual të subjektit apo i ndonjë marrëdhënieje kontraktuale personale të tij. Këto pasuri lidhen me të ardhura të krijuara nga aktiviteti bujqësor dhe blegtoral i familjes, i cili ka qenë i painedividualizuar dhe i administruar në mënyrë kolektive nga anëtarët e familjes; (v) gjatë hetimit administrativ dhe shqyrtimit gjyqësor nuk është konstatuar asnjë provë, indicie apo dyshim i arsyeshëm se pasuritë në fjalë janë krijuar përmes burimeve të paligjshme apo se subjekti i rivlerësimit apo familjarët e tij kanë qenë përfshirë në ndonjë aktivitet të jashtëligjshëm.

15. Në përfundim, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ka konkluduar se pas shqyrtimit gjyqësor, në referencë të rrethanave të konstatuara, kur kursimet *cash* të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit janë krijuar në një periudhë kur ai nuk ushtronte ndonjë funksion publik, përpara emërimit të tij në detyrë, si dhe kur nuk është konstatuar asnjë indicie që këto pasuri të kenë burim të paligjshëm apo lidhje me ndonjë veprimtari të jashtëligjshme, as nga vetë subjekti dhe as nga familjarët e tij, vlerësohet se problematikat e konstatuara në lidhje me kriterin e pasurisë nuk janë të një natyre të tillë që të justifikojnë dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit.
16. Për sa i përket kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme konkludoi se problematikat e konstatuara nuk janë në masë të tillë për t'u konsideruar si mangësi serioze në aftësitë profesionale të subjektit apo shkelje të tjera të rënda, si dhe nuk janë mangësi që të mund të cenojnë zgjidhjen e drejtë të çështjes. Si rezultat, mangësitë e konstatuara në shqyrtimin e çështjeve të trajtuara nuk janë të natyrës që të justifikojnë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.
17. Në vijim të sa më sipër, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, bazuar në parashikimet e pikës 7 të nenit F të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës "a", pikës 1, të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, kërkoi nga Kolegji lënien në fuqi të vendimit nr. 650, datë 27.04.2023, të Komisionit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj.
18. Subjekti i rivlerësimit, në këtë seancë, pasi u njoh dhe me kërkesën e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 650, datë 27.04.2023, të Komisionit.

C. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

19. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, pasi dëgjoi shpjegimet e palëve lidhur me ankimin e Komisionerit Publik, mori provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në vlerësim të situatës procedurale në të cilën ankuesi, gjatë bisedimeve përfundimtare, ndryshoi kërkimin fillestar të ankimit, duke kërkuar përfundimisht nga Kolegji që vendimi i kundërshtuar të lihet në fuqi, trupi gjykues vlerësoi si thelbësore për zgjidhjen e çështjes përcaktimin e pasojës juridike procedurale të këtij kërkimi.
20. Në mbështetje të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, përkatësisht nenit 179/b, pika 5 të Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se Institucioni i Komisionerëve Publikë, si përfaqësues i interesit publik, ka disponuar deri në përfundim të mandatit të tij kushtetues, në mënyrë të plotë dhe të pavarur të drejtën e ushtrimit të ankimit kundër vendimeve të Komisionit të Pavarur të

Kualifikimit, lidhur me procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Bazuar në parashikimet e nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës, si pasojë e mbarimit të mandatit kushtetues të këtij institucioni dhe kalimit të kompetencave të tij kushtetuese dhe ligjore te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, ky i fundit tashmë gëzon në mënyrë ekskluzive edhe të drejtën e disponimit mbi ankimet e ushtruara prej Komisionerit Publik.

21. Trupi gjykues vëren se ankimi është një mjet procedural nëpërmjet të cilit ankuesi në mbrojtje të interesit publik kundërshton mbi bazë faktike dhe ligjore drejtësinë e vendimit të Komisionit në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar. Në rast se Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, si i vetmi disponues i ankimit, deklaron para Kolegjit se nuk e kundërshton më vendimin e Komisionit, kjo nënkupton se për të nuk ekzistojnë më arsye faktike dhe ligjore për ndryshimin e vendimit të ankimuar, duke e lënë në këtë rast ankimin pa objekt dhe duke konfirmuar njëkohësisht se ndryshimi i vendimit të Komisionit nuk përbën tashmë një kërkim që i shërben interesit publik. Në këtë kontekst, lënia e ankimit pa objekt dhe humbja e interesit të ligjshëm në ushtrimin e këtij mjeti procedural, në vlerësimin e trupit gjykues, përbën në thelb një sjellje procedurale që barazohet për nga efektet me atë të heqjes dorë nga ankimi, sipas kuptimit të dhënë nga legjislatori për këtë institut procedural të parashikuar në nenin 463 të Kodit të Procedurës Civile. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se nuk kishte më lëndë procedurale për të vijuar kontrollin gjyqësor të vendimit objekt ankimi, për sa kohë ankimi humbi objektin e tij dhe ankuesi interesin e ligjshëm në mbajtjen e ankimit.
22. Në përfundim, trupi gjykues arriti në konkluzionin se pasoja e vetme ligjore për situatën faktike procedurale, si më sipër konstatuar e analizuar, është pushimi i shqyrtimit në Kolegj të çështjes së juridiksionit të rivlerësimit me nr. 37/2023 (JR), që lidhet me subjektin e rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj, pasi vijimi i gjykimit për kontrollin e vendimit të Komisionit, mbi bazën e një ankimi të mbetur pa objekt dhe në mungesë të interesit të ligjshëm të ankuesit, do të përbënte cenim të së drejtës për proces të rregullt ligjor. Ky konkluzion, i arritur edhe në vendimmarrje të mëparshme të Kolegjit, vjen si rezultat i një analize juridike në ndërthurje të së drejtës së palëve për akses në gjykatë dhe nevojës për një proces gjyqësor ku, në zbatim të parashikimeve të nenit 6, paragrafi 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, synohet garantimi i të drejtave praktike dhe efektive të palëve dhe jo i të drejtave teorike apo hipotetike.
23. Në funksion të qartësimit të pozitës procedurale të subjektit të rivlerësimit në raport me procesin e rivlerësimit kalimtar, sipas ligjit nr. 84/2016, duke konsideruar natyrën e posaçme të këtij procesi, Kolegji gjen të nevojshëm të deklarojë edhe efektin ligjor që prodhon kjo vendimmarrje në raport me vendimin e Komisionit, i cili ishte objekti i ankimit të Komisionerit Publik. Në kuptim të sa më sipër, Kolegji konstaton se në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, neneve 1, pika 2 dhe 44 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, si dhe neneve 451, shkronja “b” dhe 463 të Kodit të Procedurës Civile, vendimi nr. 650, datë 27.04.2023, i Komisionit, ndaj të cilit ishte ushtruar ankimi, do të konsiderohet se merr formë të prerë në momentin që Kolegji merr vendimin për pushimin e shqyrtimit të kësaj çështjeje.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe nenet 451, shkronja “b” e 463 të Kodit të Procedurës Civile, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pushimin e shqyrtimit të çështjes (JR) nr. 37/2023, për ankimin e Komisionierit Publik kundër vendimit nr. 650, datë 27.04.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 17.10.2025, në Tiranë.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi-kundër

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e kryesueses së trupit gjykues, jam kundër vendimit nr. 73 (JR), datë 17.10.2025, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me të cilin shumica e trupit gjykues ka vendosur: *“Pushimin e shqyrtimit të çështjes (JR) nr. 37/2023, për ankimin e Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 650, datë 27.04.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj”*, për arsyet më poshtë.
2. E vlerësoj të pabazuar arsyetimin e përdorur nga shumica e trupit gjykues, në paragrafin 21 të vendimit se: *“[...] Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, si i vetmi disponues i ankimit, deklaroi para Kolegjit se nuk e kundërshtoi më vendimin e Komisionit, kjo nënkupton se për të nuk ekzistojnë më arsye faktike dhe ligjore për ndryshimin e vendimit të ankimuar duke e lënë në këtë rast ankimin pa objekt, si dhe, duke konfirmuar njëkohësisht se ndryshimi i vendimit të Komisionit nuk përbën tashmë një kërkim që i shërben interesit publik. Në këtë kontekst, lënia e ankimit pa objekt dhe humbja e interesit të ligjshëm në ushtrimin e këtij mjeti procedural, në vlerësimin e trupit gjykues përbën në thelb një sjellje procedurale që barazohet për nga efektet me atë të heqjes dorë nga ankimi, sipas kuptimit të dhënë nga legjislatori për këtë institut procedural të parashikuar në nenin 463 të Kodit të Procedurës Civile. Në këto kushte trupi gjykues vlerësoi se nuk kishte më lëndë procedurale për të vijuar kontrollin gjyqësor të vendimit objekt ankimi, për sa kohë ankimi humbi objektin e tij dhe ankuesi interesin e ligjshëm në mbajtjen e ankimit”*.
3. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, si dhe subjekti i rivlerësimit, në fazën e bisedimeve përfundimtare, kanë kërkuar lënien në fuqi të vendimit të Komisionit. Konkluzionin e shumicës e vlerësoj të padrejtë dhe në kapërcim të dispozitave ligjore të zbatueshme për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Vlerësimin tim e mbështes në legjislacionin e zbatueshëm të procesit të rivlerësimit kalimtar. Referuar parashikimeve në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016: *“Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji”*. Pra, jo pa qëllim, ligjvënësi nuk orienton drejtpërdrejtë Kolegjin, në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, të aplikuara në këtë rast nga shumica për pushimin e shqyrtimit të çështjes. Neni 64, pika 4 e Kodit të Procedurave Administrative, përcakton se: *“Tërheqja e një pale nuk çon në përfundimin e procedurës administrative, në rast se organi publik vlerëson se vazhdimësia e procedurës është në interes publik ose në interesin e ligjshëm të palëve të tjera”*. Përsëri në referencë të ligjit nr. 84/2016, përkatësisht neni 65 pika 1 i tij, përcakton se: *“Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012, ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’”*.
4. Gjithashtu, në vlerësimin tim, ky konkluzion i shumicës së trupit gjykues, bie ndesh me kompetencat që Kushtetuta dhe ligji i njeh Kolegjit. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, si palë në gjykim, në përfundim, sipas bindjes së tij, mund të kërkojë secilën alternativë të parashikuar në ligj, por në rastin konkret shumica nuk duhej të vendoste pushimin e shqyrtimit të çështjes, duke e konsideruar në thelb situatën një sjellje procedurale që barazohet për nga efektet me atë të heqjes dorë nga ankimi, sipas nenit 463 të Kodit të Procedurës Civile.
5. Kërkimi për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme përbën një qëndrim mbi themelin e çështjes dhe nuk mund të passjellë të njëjtin efekt procedural me atë të heqjes dorë nga ankimi, sikurse ka vlerësuar shumica e trupit gjykues. Në mungesë të një deklarimi të qartë dhe të shprehur për tërheqje, e gjej të pavend konkluzionin e shumicës se [...] lënia e ankimit pa objekt dhe humbja e interesit të ligjshëm në ushtrimin e këtij mjeti procedural, në vlerësimin e trupit gjykues, përbën në thelb një sjellje procedurale që barazohet për nga efektet me atë të heqjes dorë nga ankimi [...]. Në vlerësimin tim, edhe nëse Drejtuesi i

Prokurorisë së Posaçme e tërheq ankimin në këtë fazë procedurale në mënyrë të shprehur, përsëri shumica duhej të vazhdonte procedurën, duke u shprehur përfundimisht me një vendim përfundimtar, sipas nenit 66, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në interes publik dhe në interes të vet subjektit të rivlerësimit, mbi gjitha, nga vet natyra kalimtare e këtij procesi të rivlerësimit.

6. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, përfundimisht, kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 650, datë 27.04.2023, të Komisionit, i cili ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj. Ky qëndrim është mbajtur pas mbylljes së shqyrtimit gjyqësor, duke u bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, në analizën dhe vlerësimin e situatës faktike e ligjore mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, duke vlerësuar në përfundimin se subjekti i rivlerësimit është i besueshëm për vazhdimin e detyrës. Konkluzionin e shumicës së trupit gjykues se [...] *nuk kishte më lëndë procedurale për të vijuar kontrollin gjyqësor të vendimit objekt ankimi, për sa kohë ankimi humbi objektin e tij dhe ankuesi interesin e ligjshëm në mbajtjen e ankimit*, e vlerësoj absurd dhe të pabazuar në prova dhe në ligj.
7. Si gjyqtare në pakicë, vlerësoj se situata faktike dhe ligjore, në rastin objekt shqyrtimi, e vendos Kolegjin përpara ushtrimit të kompetencave të tij kushtetuese dhe ligjore, nëpërmjet zgjidhjes në themel të çështjes për të konfirmuar nëse qëndrojnë kërkimet e palëve për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit. Shumica në kundërshtim me rregullat procedurale dhe parimet e ligjshmërisë ka vendosur pushimin e çështjes pa kryer një shqyrtim të plotë të rrethanave dhe pa u mbështetur në shkaqe të parashikuara nga ligji, duke cenuar kështu të drejtën e palës për një proces të rregullt ligjor.
8. Për efekt të procesit të rivlerësimit, Kolegji si e vetmja gjykatë e këtij procesi, referuar parimit *iura novit curia* dhe natyrës *sui generis*, në interesin publik, pavarësisht qëndrimit të palëve, në përfundim, duhet të dispononte sipas ligjit, me një vendim përfundimtar mbi meritën e çështjes. Përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin Ylli Pjetërnikaj, me një vendim jopërfundimtar për pushimin e shqyrtimit të çështjes dhe pa e zgjidhur atë në themel, për sa arsyetuar më sipër, nuk e gjej të bazuar në ligj, si dhe nuk e konsideroj as në interes të publikut dhe as në interes të ligjshëm të vetë subjektit të rivlerësimit.
9. Pavarësisht nga procedura e ndjekur dhe konkluzionit të shumicës së trupit gjykues, unë, gjyqtarja në pakicë, nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, për aq sa faktet dhe rrethanat iu nënshtruan debatit gjyqësor, përgjatë seancës gjyqësore publike, e gjej të drejtë dhe të mbështetur në prova dhe në ligj analizën faktike e ligjore të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit, i cili ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi